



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

Datë: 13.03.2017

FTESË PËR OFERTË

DOGANA E KOSOVËS publikon këtë ftesë me anën e të cilës i fton të gjithë personat juridik me qëllim të lidhjes së një kontrate për furnizimin me hapësirë objekti si në vijim:

Titulli i aktivitetit: Furnizimi me hapësirë për zyre me qira dhe hapësirë për depo me distancë deri në 5 km nga objekti i Qeverisë (ish Rilindja), sipas kërkesave në vijim:

Nr. i art.	Përshkrimi	ÇMIMI NJËSI
1/1	Hapësira për zyre prej 1700 m ²	Çmimi për m ²
1/2	Hapësirë për depo 300 m ²	Çmimi për m ²
	Vërejtje: Objekti duhet të ketë edhe hapësirë për parking – së paku për 60 vetura / automjeteve	

Kushtet që duhet t'i plotësojë ofertuesi:

- Oferta duhet të jetë dhënë nga ofertuesi apo personi i autorizuar i tij, i cili ka për qëllim t'i përgjigjet kësaj ftese; dhe
- Oferta duhet t'i përmbajë elementet thelbësore të paraqitura në kërkesat teknike dhe ligjore si në Aneksin 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Mënyra e paraqitjes së ofertës:

Oferta duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur dhe duhet t'i përmbajë këto dëshmi:

- Formularin e Çmimit;

2. Dëshmi me shkrim se ofertuesi plotëson kërkesat teknike të Specifikimit Teknik të Detyrueshëm;
3. Përshkrimin e objektit të hapësirës me të dhënat teknike;
4. Dokumentacionin grafik me planin e objektit, ku përfshihet edhe lokacioni i objektit; dhe
5. Fotografitë e objektit.

Kushtet e ofertimit: Të gjithë të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e Specifikimit Teknik të Obligueshëm pranë Zyrës së Prokurimit të Doganës së Kosovës, në adresën: Lagjja Kalabri, Rr. “Rexhep Krasniqi”, Prishtinë çdo ditë pune prej orës 09.00-16.00 ose edhe në e-mailin zyrtar: prokurimi@dogana-ks.org dhe tel: +381 (0) 38 540 797.

Oferta e nënshkruar dhe e mbyllur në zarf do të pranohen nga Dogana jo më vonë se: 24.03.2017, koha 14:00, Zyra e Prokurimit, Dogana e Kosovës. Adresa: Lagjja Kalabri, Rr. “Rexhep Krasniqi” 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Sinqerisht,
Dogana e Kosovës